

Miratohet Strategjia “Për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve në mbikëqyrje 2018-2022”

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2018
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2018

Zhvillime të tjera

- Edukimi financiar - faktor i rëndësishëm për rritjen e tregut të kapitalit
- AMF në vizitë pune pranë Autoritetit Kroat të Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare
- AMF, pranë studentëve të Universitetit “Fan S. Noli” në Korçë
- Zhvillohet mbledhja dy ditore e kolegjeve të mbikëqyrjes për Grupet e Sigurimit UNIQA, VIG, GRAWE, Merkur, Wüstenrot & FWU
- Vizitë studimore për mbikëqyrjen e tregjeve financiare

Edukimi i Konsumatorit

- Inovacioni si urë zhvillimi për sigurimet dhe pensionet

Lajme Ndërkombëtare

- Hungari
- Qipro
- Serbi
- Slloveni
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Miratohet Strategjia “Për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje 2018-2022”



Synimi i AMF-së është që zbatimi i kësaj Strategjie të nxisë zhvillimin e një tregu konkurrent dhe eficient, duke vënë në qendër të saj konsumatorin dhe investitorin.

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare miratoi Strategjinë “Për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje 2018-2022”. Kjo Strategji pasqyron analizën, vlerësimin dhe jep rekomandime për tregjet financiare jobankare.

Strategjia vendos edhe elementët prioritarë të zhvillimeve të ardhshme:

- Zhvillimin e tregjeve financiare jobankare në Shqipëri dhe përparimin e tyre me ritëm të shpejtë duke synuar ritmet e rritjes së vendeve të rajonit;
- Përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të mbikëqyrjes edhe nëpërmjet rritjes së kapaciteteve profesionale;
- Inovacioni teknologjik që do të lehtësojë nevojat në rritje të konsumatorit për realizimin e veprimeve online;
- Hartimin dhe miratimin e një kuadri ligjor të harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për tregjet financiare jobankare.

Synimi i AMF-së është që zbatimi i kësaj Strategjie të nxisë zhvillimin e një tregu konkurrent dhe eficient, duke vënë në qendër të saj konsumatorin dhe investitorin.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-mars 2018

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-mars 2018 kapën vlerën mbi 3.55 miliardë lekë, ose 2.53% më shumë se gjatë periudhës janar-mars 2017. Gjatë periudhës janar-mars 2018, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 261,173 me një rritje prej 5.5% krahasuar me periudhën janar-mars 2017.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një ulje me 22.03% në krahasim me periudhën janar-mars 2017. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 805 milionë lekë, apo 14.61% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 3.54% gjatë periudhës janar-mars 2018, krahasuar kjo me periudhën janar-mars 2017.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 2.2 miliardë lekë gjatë periudhës janar-mars 2018, duke shënuar një rritje prej 6.48% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 62.22% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen: Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 11.47% të tregut të Jo-Jetës; Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 15.52 % të tregut të Jo-Jetës.


Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulen me 4.43% krahasuar me periudhën janar-mars 2017. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 64.48% të sigurimit të Jetës.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-mars 2018 kapën vlerën mbi 3.55 miliardë lekë, ose 2.53% më shumë se gjatë periudhës janar-mars 2017.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar–mars 2018

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore:



Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2018


Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2018 u dominua në masën 90.77% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 9.23% ishin instrumente afatgjatë (obligacione).

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2018 u dominua në masën 90.77% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 9.23% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 94.35% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera në bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2018 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 60.16% dhe 29.98% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.77% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Grafik: Letra me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-mars 2018



- A. Blerje në tregun primar
- B. Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar
- C. Blerje para afatit të maturimit
- D. Vendosje e bonos si kolateral
- E. Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-mars 2018, ka pasur një ulje prej 318 milionë lekë ose 18.59% krahasuar me periudhën janar-mars 2017. Ndërkohë numri i transaksioneve është rritur në masën 21.89%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-mars 2018, ka pasur ulje prej 32 milionë lekë ose 6.06% dhe gjithashtu, një ulje në numrin e transaksioneve në masën 17.65%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 350 milionë lekë, krahasuar me periudhën janar-mars 2017.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale		Ndryshimi
		(në mln. lekë)		(në %)
Janar-Mars		2017	2018	'18/'17-1
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	1,710.94	1,392.79	(18.59)
	Individë	1,710.94	1,372.79	(19.76)
	Persona juridikë	-	20.0	100.00
C	Blerje para afatit të maturimit	519.79	488.28	(6.06)
	Individë	519.79	488.28	(6.45)
	Persona juridikë	-	2.00	100.00

Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 350 milionë lekë, krahasuar me janar-mars 2017.

Nga një anketim me studentë, i ndërmarrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, vërehet se njohuritë e tyre për tregjet financiare jobankare, në mbi 90% të të intervistuarve, janë të pakta dhe të pamjaftueshme lidhur me letrat me vlerë, fondet private të pensione apo edhe fondet e investimeve.

Edukimi financiar - faktor i rëndësishëm për rritjen e tregut të kapitalit


(analizë nga anketimi me studentët)

Edukimi i publikut dhe sidomos i brezave të rinj shihet si një ndër elementët e rëndësishëm në zhvillimin e tregjeve financiare jobankare. Në Strategjinë e Afatmesme të Zhvillimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Ervin Koçi, e kanë konsideruar si element kyç mbrojtjen, fuqizimin dhe edukimin financiar të Konsumatorit dhe Investitorit. Synimi është t'i shndërrojë ata në investitorë të rëndësishëm dhe pjesëmarrës në zhvillimin ekonomik të vendit.

Nga një anketim me studentë, i ndërmarrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, vërehet se njohuritë e tyre për tregjet financiare jobankare, në mbi 90% të të intervistuarve, janë të pakta dhe të pamjaftueshme lidhur me letrat me vlerë, fondet private të pensione apo edhe fondet e investimeve. Për tregun e sigurimeve, niveli i informacionit është më i lartë, por i lidhur kryesisht me produkte të sigurimeve të detyrueshëm, apo produktet që i lidhin studentët me procedurat e regjistrimit në shkollë. Anketimi u realizua me studentë që i përkasin moshave 18-25 vjeç, të fakulteteve ekonomike dhe juridike të disa universiteteve publike dhe private në qytetet Tiranë, Durrës dhe Elbasan në periudhën tetor 2017 – mars 2018. Duke interpretuar rezultatet e marra nga ky anketim është e nevojshme që edukimi financiar duhet të shtrihet më herët, që në nivelin e shkollës 9-vjeçare e të mesme, por ajo çfarë është më e rëndësishme, ky edukim me konceptet financiare duhet të jetë edhe më i thelluar.


Informacioni për tregun e sigurimeve është interesant të vlerësohet se pyetjes, se: a mendoni që sigurimi i pasurisë nga fatkeqësitë natyrore (tërmetet, përmytjet) është një sigurim i nevojshëm që duhet ta bëjnë të gjithë qytetarët, 81% e të anketuarve i përgjigjen pozitivisht. Po kështu rreth 70% e studentëve të intervistuar mendojnë se ata apo familjet e tyre mund të paguajnë për sigurime vullnetare shifra mesatare vjetore që luhaten nga 10,000-30,000 lekë në vit. Dhe interesimi i tyre më i madh është për sigurimin e Jetës dhe të Shëndetit.

A mendoni se sigurimi i pasurisë nga fatkeqësitë natyrore (tërmetet, përmytjet) është një sigurim i nevojshëm që duhet ta bëjnë qytetarët?



Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare e ka vendosur
si prioritet dhe ka marrë
një rol të rëndësishëm në
procesin e edukimit
konsumator dhe për rritjen
e besimit në tregjet nën
mbikëqyrje.

Përsa i përket dy tregjeve të tjera financiare jobankare, tregu i pensioneve private vullnetare dhe tregu i kapitaleve e fondeve të investimeve, mungesa e informacionit i bën studentët më pasivë për pjesëmarrjen në to. Më tepër se 70% e përgjigjeve të studentëve të anketuar nuk janë të gatshëm për t'u përfshirë në skema të tilla. Nga përgjigjet shpjeguese të studentëve ky hezitim lidhet kryesisht me nivelin e të ardhurave, por po kështu edhe me paqartësinë për mundësitë e reziqet që ato përmbajnë, si edhe me mungesën e informacionit. Mungesa e informacionit ka ndikuar edhe në përzgjedhjen dhe dallimin midis investimit në fonde të pensioneve private vullnetare dhe në fonde të investimeve, ku studentët dukshëm preferojnë më tepër përfshirjen në fondet e investimeve.



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e ka vendosur si prioritet dhe ka marrë një rol të rëndësishëm në procesin e edukimit konsumator dhe për rritjen e besimit në tregjet nën mbikëqyrje. Këtyre objektivave u shërben më mirë edhe ngritja në nivel drejtorie e mbrojtjes së konsumatorit si pjesë e strukturës së re të miratuar nga Bordi i AMF-së në vitin 2017. Ndërtimi i kësaj strukture u bë duke iu përshtatur zhvillimeve të sotme dhe dinamikës së rritjes së tregjeve si një ndër objektivat e rëndësishme të AMF-së. Struktura e re u konsultua ngushtësisht edhe me institucionet ndërkombëtare me të cilat bashkëpunon Autoriteti. Gjithashtu, Bordi i Autoritetit miratoi edhe Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Rritjen e Besimit të Konsumatorit për Tregjet nën Mbikëqyrje.

Strategjia parashikon disa aktivitete të cilat synojnë të rrisin praninë e AMF-së te publiku, informacionin për publikun mbi rolin e AMF-së dhe tregjet që ai rregullon dhe mbikëqyr. Ato përqendrohen në çështjet me prioritet të lartë, dhe të merren parasysh në kuadrin rregullator dhe administrativ, të konsiderohen si një mjet për nxitjen e rritjes ekonomike, besimit dhe stabilitetit, së bashku me rregullimin e institucioneve financiare nën mbikëqyrje dhe mbrojtjen e konsumatorit/investitorit. Ky është një proces i vazhdueshëm dhe merr parasysh rritjen e kompleksitetit të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, si dhe nevoja të ndryshme informuese në faza të ndryshme të këtyre tregjeve.

Megjithatë mendohet që puna dhe strategjitë për edukimin financiar japin efekt më të madh nëse ato shtrihen në nivel kombëtar dhe me përpjekje të kombinuara nga disa institucione.

Megjithatë mendohet që puna dhe strategjitë për edukimin financiar japin efekt më të madh nëse ato shtrihen në nivel kombëtar dhe me përpjekje të kombinuara nga disa institucione. Kështu bashkimi i përpjekjeve të Autoritetit me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, medias, si edhe organizmat ndërkombëtarë për hartimin dhe zbatimin e një strategjie kombëtare do të sjellë rritje të nivelit të edukimit financiar në vend.

Në këtë kuadër, vetëm gjatë vitit të fundit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin “Aleksandër Moisiu” të Durrësit, Universitetin “Mesdhetar të Shqipërisë”, Universitetin “Albanian University”, Kolegjin Universitar Luarasi dhe Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. Këto marrëveshje dhe të tjerat që do të nënshkruhen në vazhdimësi gjatë këtij viti i shërbejnë studentëve për të marrë më shumë njohuri mbi tregjet financiare jobankare që mbikëqyr AMF, si nëpërmjet praktikave profesionale, pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe mbështetjes së punimeve të diplomave apo studimeve për studentët me rezultate të larta.

Këtij synimi i shërben edhe Konferenca III Kombëtare që Autoriteti do të organizojë më 24 maj 2018 “Sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe edukimi financiar”. Në njërin nga panelet e konferencës do të prezantohen punimet më të mira të përzgjedhura të studentëve dhe pedagogëve me tematika nga tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Konferenca do të ofrojë një mundësi për të paraqitur punimet e studentëve dhe pedagogëve si edhe për të ndarë njohuri, eksperiencë dhe këndvështrime akademike lidhur me tregjet financiare jobankare. Mbi 30 punime nga studentë dhe pedagogë janë paraqitur për të marrë pjesë në Konferencën “Sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së dhe edukimi financiar” më 24 maj 2018. Tematikat prekin kryesisht çështje që lidhen me sigurimet dhe ndryshimet që po pëson ky treg në epokën digjitale. Tematika të tjera lidhen edhe me tregun e kapitaleve si dhe tregun e fondeve të pensioneve private vullnetare.

Diana Kalaja
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

AMF në vizitë pune pranë Autoritetit Kroat të Mbikëqyrjes së Tregjeve Financiare

Në datat 8-10 prill 2018, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe disa drejtues të drejtorive dhe departamenteve të AMF-së zhvilluan një vizitë pune pranë zyrave të Autoritetit Mbikëqyrës Kroat (HANFA) në Zagreb të Kroacisë. Në vazhdim takime pune u organizuan edhe në një nga shoqëritë administruese të fondeve të pensionit si edhe pranë Byrosë Kroate të Sigurimeve. Objektivi kryesor i kësaj vizite studimore ishte marrja e eksperiencës kroate në ngritjen e Autoritetit, mbikëqyrjen e tregjeve, si dhe zgjidhjet lidhur me teknologjinë e informacionit.

Agjencia e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare, HANFA është krijuar më 1 janar 2006, dhe funksioni i saj është mbikëqyrja dhe rregullimi i tregut të kapitalit, tregut të sigurimeve dhe fondeve të pensionit dhe sigurimeve. Burimet e financimit të kësaj agjencie janë nga buxheti i shtetit, kontribute nga subjektet nën mbikëqyrje dhe komisione për shërbime që ofron HANFA. Struktura e kësaj agjencie funksionon tërësisht vertikale, sipas tregjeve nën mbikëqyrje.

Tregu i sigurimeve

Departamenti i tregut të sigurimeve i HANFA ishte organizuar në tre drejtori: Drejtoria e Inspektimit (*On-site*), Drejtoria (*Off-site*) e Analizës së Riskut, si dhe Drejtoria e Licencimit dhe Mbështetjes Ligjore, e cila ishte e specializuar në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

Tregu kroat i sigurimeve në 31.12.2017 përbëhej nga 20 shoqëri sigurimi, nga të cilat 5 shoqëri Jetë, 7 Jo-Jetë dhe 8 shoqëri kompozitë. Mbikëqyrja e tregut të sigurimit dhe risigurimit kryhej sipas regjimit të *Solvency II*.

Procesi i Mbikëqyrjes kryhet nga Drejtoria e Analizës dhe Riskut (*Off-site*) dhe ajo e Inspektimit (*On-site*), bazuar në metodologjinë e mbikëqyrjes me bazë rrezikun. Një nga elementët e përbashkët të këtij procesi ishte kryesisht komunikimi me qeverisjen korporative të shoqërive të sigurimit, nëpërmjet takimeve apo intervistave të ndryshme me anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës apo funksionarë kryesorë të shoqërisë, lidhur me problematikat e konstatuara gjatë mbikëqyrjes off site dhe inspektimit në vend.

Lidhur me përshtatjen ligjore dhe të gjitha funksioneve të autoritetit rregullator sipas kërkesave të Direktivave Evropiane për tregun e sigurimeve, përfaqësuesit e HANFA u shprehën se duhet ndërtuar një Road Map, për të orinetuar këtë proces, i cili kërkon gjithashtu edhe asistencë nga ekspertë të fushës së sigurimeve. Mali i Zi dhe Maqedonia kanë filluar procesin e përshtatjes, i cili sipas HANFA zgjat përafërsisht 2 vjet.

Në datat 8-10 prill 2018,
Drejtori i Përgjithshëm
Ekzekutiv i AMF-së, Z.
Ervin Koçi dhe disa
drejtues të drejtorive dhe
departamenteve të AMF-së
zhvilluan një vizitë pune
pranë zyrave të Autoritetit
Mbikëqyrës Kroat (HANFA)
në Zagreb të Kroacisë.

Gjatë kësaj vizite u bënë takime me drejtues të departamentit të tregut të kapitaleve, si dhe u vizituan institucionet si Bursa, Depozitari Qendror, si dhe një nga fondet e pensionit.

Tregu i Kapitaleve

Gjatë kësaj vizite u bënë takime me drejtues të departamentit të tregut të kapitaleve, si dhe u vizituan institucionet si Bursa, Depozitari Qendror, si dhe një nga fondet e pensionit. Në këto takime iu kushtua një vëmendje e veçantë pjesëmarrësve të tregut, aktivitetit të bursës ZSE dhe Depozitarit Qendror, tregut të fondeve të pensionit, etj.

Pjesëmarrësit e tregut të kapitaleve në Kroci ishin: Zagreb Stock Exchange (ZSE), Central Depository & Clearing Company (SKDD), ndërmjetësit (7 firma investimi, 15 institucione krediti, 8 shoqëri menaxhimi, ofrues të shërbimeve nga vende të tjera të EU), fonde (pensioni dhe investimesh), 138 kompani të listuara (përfshi ZSE), si dhe investitorët.

Bursa ZSE është ngritur në 1991 me një kapital fillestar rreth 6 milionë euro, aktualisht ishte në pronësi të anëtarëve, fondeve të pensionit dhe EBRD-së. Hyrja e kompanive në bursë shumë vite më parë i dedikohet edhe ligjit të asaj kohe që i kishte detyruar kompanitë të listoheshin. Segmentet e tregut ishin tregu i rregulluar dhe MTF. Në tremujorin e parë të 2018, Bursa kishte një *turnover* prej 85 milionë euro me rreth 33,000 transaksione. Gjithsesi pjesën më të madhe të tregimit në Bursë e zinin letrat me vlerë të borxhit (70%), kundrejt letrave me vlerë të pronësisë. Kapitalizimi i tregut ishte rreth 31 miliardë euro.

Sa i përket fondeve të pensioneve që nga fillimi i 2002 është e organizuar në tre shtylla, dy nga të cilat detyruese dhe e treta vullnetare. Reforma e fondeve të pensioneve hyri në fuqi në janar 2002 e mbështetur nga Banka Botërore. Në tregun kroat operonin 6 kompani administrimi të fondeve, 4 nga të cilat menaxhonin fonde të shtyllës së dytë edhe të shtyllës së tretë.

Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimeve

E gjithë infrastruktura e serverave të HANFA ishte e virtualizuar, çka sjell siguri të informacionit më të madh dhe disponueshmëri më të lartë në rast problemesh. E gjithë infrastruktura ishte e përbërë nga site primar, që ndodhej në godinën e HANFA dhe nga site sekondar, në të cilën ishte *Disaster Recovery Site*.

Infrastruktura aplikative ishte një sistem kryesor raportimi të të dhënave financiare e statistikore nga kompanitë nën mbikëqyrjen e HANFA, duke përfshirë tregun e sigurimeve, të kapitaleve, fondet e pensioneve dhe fondet e investimeve. Mënyra e raportimit nga ana e kompanive nën mbikëqyrje ishte shumë e ngjashme me atë të VIZOR në AMF duke plotësuar forma të gatshme ose duke ngarkuar template në formatin Excel dhe duke i bërë të vlefshme nëpërmjet rregullave të paracaktuara. Por ndryshimi ishte në raportet e standardizuara që HANFA dërgonte në mënyrë automatike drejt EIOPA dhe ESMA, të cilat do të jenë të ngjashme edhe për AMF-në kur të përshtaten me kushtet e raportimit të *Solvency II*.

Byroja e Sigurimit (HUO)

Byroja Kroate e Sigurimeve është themeluar në vitin 1992, si Byroja për Kartonin Jeshil në Republikën e Kroacisë. Përgjegjësitë e Byrosë Kroate të Sigurimeve janë zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme në dy dekadat e fundit, siç përcaktohet në Ligjin e Sigurimeve dhe Statutin e Byrosë Kroate të Sigurimeve. Funkcionet e Byrosë Kroate të Sigurimeve, janë të zgjeruara dhe organizimi i saj është i ndarë në departamente, përkatësisht: Byroja e Kartonit Jeshil, Fondi i garancisë/përfaqësuesi i dëmeve, Qendra e informacionit, Qendra e ndërmjetësimit, zgjidhja e ankesave dhe Qendra e Edukimit.

Fondi i Garancisë

Asetet e Fondit të garancisë mbahen të ndara nga asetet e tjera të Byrosë. Fondi i garancisë administrohet nga HUO dhe ka për qëllim pagesat e kërkesave për dëme dhe ose humbje:

- Të shkaktuara nga mjetet me regjistrim në Kroaci, të cilat garantohen nga Fondi i Garancisë sipas ligjit;
- Të ndodhura në territorin e Republikës së Kroacisë shkaktuar nga mjetet e pasiguruara dhe të paidentifikuara;
- Të ndodhura nga mjetet e pasiguruara të transportit publik;
- Nga dëmet e sigurimit kufitar.

Byroja Kroate e Sigurimeve financohet nga kontributet e anëtarëve. Për të mundësuar pagesat e kërkesave nga Fondi i Garancisë në përputhje me Ligjin e Sigurimeve, të gjithë anëtarët janë të detyruar të kontribuojnë në financimin e Fondit të Garancisë në përputhje me Ligjin dhe me Urdhrat e HANFA. Me zhvillimin e vendeve të EU, me qëllim mbrojtjen e tregut të sigurimeve, në rast të pamjaftueshmërisë së kapitalit nga siguresit, Byroja kroate ka propozuar ndryshime të ligjit duke vendosur një pagesë periodike në fondin e garancisë në shumën prej 0.5% të primeve MTPL, si është në rastin e Gjermanisë. Ky propozim është pranuar dhe është përfshirë në ndryshimet e ligjit të bëra në vitin 2013.

Byroja Kroate e Sigurimeve është angazhuar për reduktimin e numrit të automjeteve të pasiguruara në Kroaci nëpërmjet Fushatës Kombëtare Edukuese "Ndalo/Stop drejtimin e mjetit të pasiguar". Shifrat e fundit tregojnë një rënie prej 78.7% të ankesave për rastet e mospagimit që nga fillimi i fushatës.

Përgjegjësitë e Byrosë Kroate të Sigurimeve janë zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme në dy dekadat e fundit, siç përcaktohet në Ligjin e Sigurimeve dhe Statutin e Byrosë Kroate të Sigurimeve.

AMF, pranë studentëve të Universitetit “Fan S. Noli” në Korçë

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 16 prill 2018, një leksion të hapur me studentët e Fakultetit Ekonomik në Universitetin “Fan S. Noli” në Korçë. Gjatë aktivitetit u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Universitetit “Fan S. Noli” nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori i Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, Prof. Dr. Ali Jashari. I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe Zv/ Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Z. Ervin Demo.



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Rektori i Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, Prof. Dr. Ali Jashari gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Sipas Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar sjell një mbrojtje më të mirë të konsumatorëve. Z. Koçi theksoi se të gjitha vendimet e marra vitin e kaluar, por edhe ato gjatë këtij viti kanë qenë në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, Z. Koçi theksoi se edukimi financiar në lidhje me tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së, për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin te publiku është shndërruar në një nga prioritetet e punës së Autoritetit. Për këtë arsye, Autoriteti synon që në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit të përfshijë në kurrikulat shkollore disa njohuri të përgjithshme mbi tregjet nën mbikëqyrje.

Sipas Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit financiar sjell një mbrojtje më të mirë të konsumatorëve. Z. Koçi theksoi se të gjitha vendimet e marra vitin e kaluar, por edhe ato gjatë këtij viti kanë qenë në funksion të mbrojtjes së konsumatorit dhe investitorit.

Z. Koçi i inkurajoi studentët të bëhen pjesë aktive e Konferencës së parë Kombëtare me titull: “Problemet dhe sfidat e zhvillimit të tregjeve nën mbikëqyrje dhe rëndësia e edukimit financiar”. Ata mund të kontribuojnë me punime të ndryshme për çështje që lidhen me tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit.

Nga ana e tij, Rektori Jashari u deklarua besimplotë se marrëveshja e nënshkruar mes dy institucioneve do të jetë me përfitim reciprok. Ajo do t'i shërbejë studentëve të universitetit, duke i krijuar mundësinë e intershipeve pranë Autoritetit.

Ndërsa Zv/Ministri Demo falenderoi Autoritetin për nismën e nisur për edukimin financiar dhe u shpreh i hapur për thellimin e bashkëpunimit në funksion të rritjes së njohurive tek të rinjtë.

Autoriteti Austriak i Tregut Financiar zhvilloi në datat 16 dhe 17 prill, në Vjenë, Austri, mbledhjen dy ditore të kolegjeve të mbikëqyrjes për Grupet e Sigurimit UNIQA, VIG, GRAWE, Merkur, Wüstenrot & FWU.

Zhvillohet mbledhja dy ditore e kolegjeve të mbikëqyrjes për Grupet e Sigurimit UNIQA, VIG, GRAWE, Merkur, Wüstenrot & FWU

Autoriteti Austriak i Tregut Financiar zhvilloi në datat 16 dhe 17 prill, në Vjenë, Austri, mbledhjen dy ditore të kolegjeve të mbikëqyrjes për Grupet e Sigurimit UNIQA, VIG, GRAWE, Merkur, Wüstenrot & FWU.

Mbledhja u zhvillua në katër faza kryesore:

- Faza e parë trajtoi anketimin mbi proceset dhe afatet e ndjekura nga secili rregullator. Nga 21 anketime të mbikëqyrësëve nga vëndet ku ushtrojnë aktivitetin grupet UNIQA, VIG, GRAWE, Merkur, Wüstenrot & FWU u nxorrën konkluzione mbi Hierarkinë, Planifikimin dhe Afatet, si dhe Rishikimin e nivelit të rezikut (risk scoring). Pothuajse të gjithë rregullatorët homologë pjesmarrës theksuan faktin që analizat vjetore përfundimtare mbi raportimet e shoqërive të sigurimit dhe grupet e sigurimit përfundonin pas marrjes së Raporteve të Shoqërive Audituese.
- Faza e dytë konsistoi në Raportin Mbikëqyrës Periodik dhe Raportin mbi Gjendjen e Kapitalit dhe Gjendjen Financiare të vitit 2017 ku fokusi ishin analizat e kryera, metodologjia e përdorur, trajtimi i gjetjeve dhe rekomandimeve të rregullatorit dhe komunikimi i tyre; Sistemet e analizës dhe adresimit të rezikut dhe rolin e tyre në procesin e mbikëqyrjes; Procesin e shqyrtimit dhe mbikëqyrës të grupeve të sigurimit nën mbikëqyrjen e BaFin me fokus bashkërendimin e punës me rregullatorët homologë.

- Faza e tretë konsistoi në një panel diskutimi mbi konvergjencën e mbikëqyrësve, si dhe prezantim nga ana e përfaqësuesve të EIOPA-s lidhur me këtë eksperiencë.
- Faza e katërt konsistoi në një prezantim të Autoritetit Austriak të Tregut Financiar lidhur me menyrën dhe afatet e reja dhe çështjet që do të trajtohen në kolegjin e ardhshëm për prezantimin mbi raportimin e grupit si dhe procesi i shqyrtimit mbikëqyrës.

Së fundi, Autoriteti Austriak i Tregut Financiar parashtroi para mbikëqyrësve afatet e reja të raportimit në kuadër të mbikëqyrjes së grupeve të sigurimit. Procesi parashikohet të nisë më datë 1 qershor të çdo viti dhe cikli do të përmbyllet në 1 prill të vitit të ardhshëm.

—○○○—
Përfaqësuesit e CONSOB u treguan shumë të gatshëm të ofrojnë eksperiencën e tyre dhe të asistojnë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në nevojat e tij për një mbikëqyrje efektive të tregut të kapitaleve.

Vizitë studimore për mbikëqyrjen e tregjeve financiare

Në kuadër të Projektit “Forcimi i Kapaciteteve Mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek Zhvillimi i Tregut të Kapitaleve”, financiar nga SECO, faza e tretë, në datat 10-13 prill u organizua një vizitë studimore pranë Autoritetit Italian për Mbikëqyrjen e Tregjeve Financiare (CONSOB). Faza e tretë e projektit synon trajnimin e stafit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me synim forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të tij përballë zhvillimeve të tregut të kapitaleve në Shqipëri.

Në këtë vizitë studimore, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përfaqësohej nga Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtor Ekzekutiv i AMF-së dhe drejtues të lartë të Autoritetit.

Gjatë takimeve, Znj. Mimoza Kaçi i komunikoi përfaqësuesve të Rregullatorit Italian zhvillimet më të fundit të tregut të kapitaleve në Shqipëri, përfshirë edhe licencimin e Bursës Shqiptare të Titujve, ALSE.

Përfaqësuesit e CONSOB u treguan shumë të gatshëm të ofrojnë eksperiencën e tyre dhe të asistojnë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në nevojat e tij për një mbikëqyrje efektive të tregut të kapitaleve.

Gjatë kësaj vizite studimore, përfaqësues të departamenteve të ndryshme të CONSOB prezantuan në detaje punën e tyre dhe asistuan Autoritetin në pyetjet e ndryshme lidhur me mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve, mbikëqyrje të cilën CONSOB e realizonte me anë të metodologjisë me bazë rrezikun.

Temat të cilat u diskutuan gjatë këtyre takimeve ishin:

1. Struktura, organizimi, funksioni, përgjegjësitë dhe fuqitë e Autoritetit Italian për Mbikëqyrjen e Tregjeve Financiare, CONSOB;
2. Roli i marrëdhënieve ndërkombëtare për një mbikëqyrje efektive;
3. Mbikëqyrja e tregjeve të titujve dhe tregtimi i titujve;
4. Rregullimi dhe mbikëqyrja e infrastrukturës së tregut;
5. Monitorimi i depozitarit qendror dhe sistemeve të klerimit dhe shlyerjeve;
6. Autorizimi dhe publikimi i prospekteve dhe këndvështrimi i kuadrit ligjor të BE-së në lidhje me prospektet;
7. Mbrojtja e konsumatorit dhe investitorit;
8. Mbikëqyrja e ndërmjetësve financiarë në tregun e titujve;
9. Trajtimi i çështjeve për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit në tregjet e instrumenteve financiare.

Përveç shkëmbimit të eksperiencave dhe përfitimit nga praktikat më të mira të Rregullatorit Italian në Mbikëqyrjen e Tregjeve të Kapitalit, kjo vizitë studimore i shërbeu rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit mes AMF-së dhe CONSOB-it.

Gjatë kësaj vizite studimore, përfaqësues të departamenteve të ndryshme të CONSOB prezantuan në detaje punën e tyre dhe asistuan me përkushtim AMF-në në pyetjet e ndryshme lidhur me mbikëqyrjen e tregut të kapitaleve, mbikëqyrje të cilën CONSOB e realizonte me anë të metodologjisë me bazë rrezikun.

Inovacioni si urë zhvillimi për sigurimet dhe pensionet

François Villeroy de Galhau

Guvernator

Banka e Francës

Konferenca e 7-të vjetore e EIOPA-s

Frankfurt, 22 nëntor 2017

Programi i konferencës së këtij viti iu dedikua temës “Sigurimet dhe pensionet nga një perspektivë e re”. Konferenca ishte e ndarë në disa panele kryesore si: (i) Mbikëqyrja e integruar, që lidhet me rritjen e aktivitetit ndërkufitar në Evropë, e cila sjell nevojën për një mbikëqyrje më të bashkërenduar; (ii) Si mundet që rregullimi të ndihmojë inovacionin, duke ruajtur njëkohësisht edhe një nivel të lartë të mbrojtjes konsumatore; (iii) Si mund të funksionojë më mirë për qytetarët sistemi Pan Evropian i Pensioneve Personale (PEPP); (iv) E ardhmja e sigurimeve dhe ndërlidhja e saj me teknologjinë.

Më poshtë është e përmbledhur fjala e Z. Villeroy de Galhau, Governator i Bankës së Francës, si edhe President i Autoritetit Mbikëqyrës të Francës, (Autorité de Contrôle Prudentiel et de Résolution, ACPR), i cili mbikëqyr si kompanitë e sigurimeve, ashtu edhe bankat në Francë. Tregu i sigurimeve në Francë është i dyti më i madh në Bashkimin Evropian, pas atij në Britaninë e Madhe. Z. Villeroy u ndal në fjalën e tij në tre llojet e inovacionit: institucional, ekonomik dhe teknologjik. Në fjalën e tij z. Gabriel Bernardino preku katër tema që përfshijnë prioritetet kryesore strategjike të EIOPA-s.

(Marrë me shkurtime e redaktime)

Inovacioni Institucional

Në lidhje me inovacionin institucional para së gjithash dua të vlerësoj EIOPA-n, e cila që prej krijimit të saj në janar 2011, ka bërë një punë shumë të madhe për të promovuar rregullore të qëndrueshme dhe të qarta, si edhe praktika të harmonizuara të mbikëqyrjes në Bashkimin Evropian. Krijimi i EIOPA-s erdhi si nevojë e një mbikëqyrjeje më të integruar pas krizës financiare të periudhës 2007-2008 dhe mendoj se ishte një sukses.

Në kontekstin e integritimit financiar të tregjeve, EIOPA ka dhënë kontributin e saj për të garantuar një fushë veprimi të njëjtë për të gjithë aktorët në sektorin e sigurimeve dhe pensioneve vullnetare brenda BE-së, në koordinim me autoritetet kombëtare dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse Evropiane. Ky kuadër i mirëekuilibruar mbikëqyrjeje na ndihmon të adresojmë inovacionin institucional, që kemi nisur të shohim si pasojë e Brexit.

Disa kompani britanike po marrin në konsideratë mundësinë e krijimit të degëve të tyre në Bashkimin Evropian, të shpërndajnë emrin e kompanisë, por duke ruajtur burimet e tyre në Britaninë e Madhe. Jam plotësisht dakord me EIOPA-n se duhet të jemi vigjilentë në këtë drejtim. Për më tepër që Brexit sjell me vete disa rreziqe dhe për pasojë nevojën e planeve për t'i adresuar ato.

Krijimi i EIOPA-s erdhi si nevojë e një mbikëqyrjeje më të integruar pas krizës financiare të periudhës 2007-2008 dhe mendoj se ishte një sukses.

Për të ardhmen, është me vlerë të marrim në konsideratë nevojën e rregullimit të kuadrit institucional evropian, në mënyrë që ai të jetë sa më eficient.

E kam fjalën këtu për policëmbajtësit evropianë, që kanë një kontratë direkt me kompanitë britanike dhe që duhet të vazhdojnë të përfitojnë nga e njëjta mbrojtje. EIOPA, në bashkëpunim me autoritetet britanike, i ka vënë në dijeni kompanitë britanike se duhet të përpilojnë plane për t'u përballur me Brexit, edhe pse negociatat po vazhdojnë. Kjo bëhet për të garantuar një Brexit sa më të butë, me pasoja të kufizuara për policëmbajtësit.

Për të ardhmen, është me vlerë të marrim në konsideratë nevojën e rregullimit të kuadrit institucional evropian, në mënyrë që ai të jetë sa më eficient. Ekzistojnë dy fusha ku nevojitet kujdes i veçantë, në mënyrë që konsumatorët evropianë të jenë të mbrojtur pavarësisht nga vendndodhja e siguruesit në Bashkimin Evropian: sigurimi në ndërtim dhe sigurimi i shëndetit.

EIOPA ka prezantuar tashmë disa platforma bashkëpunimi për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit në lidhje me sigurimin në ndërtim. Ne jemi në favor të iniciativave dhe përshtatjes së masave për të harmonizuar praktikën mbikëqyrëse. Njëkohësisht, duhet të bëhet dallim i qartë midis mbikëqyrjes së përditshme e cila i takon autoriteteve përkatëse kombëtare dhe rolit harmonizues rregullator që duhet të luajë EIOPA.

Përveç ndryshimeve të kuadrit institucional evropian, është e domosdoshme të sigurohet progres në përpjekjet për krijimin e një mekanizmi evropian, i cili do të zotëronte më shumë mjete të nevojshme për të kufizuar ndikimin e falimentimit të ndonjë siguruesi dhe të rriste besimin në treg. Franca ka punuar në këto drejtime në nivel kombëtar dhe një mekanizëm i tillë do të jetë në funksion përpara muajit dhjetor.

Inovacioni Ekonomik

Ndërkohë që ekonomia evropiane është pranë “kufirit teknologjik”, bizneset duhet të përqafojnë më shumë inovacionin. Ata duhet të jenë të gatshëm të marrin përsipër më shumë rreziqe, që kërkojnë më shumë financim afatgjatë të kapitalit, në vend të financimit të borxhit. Në këtë kuadër, Eurozona ka mbetur shumë mbrapa krahasuar me SHBA, megjithëse burimet janë të bollshme, pasi kursimet nga investimet llogariten në 350 miliardë euro në vit, që përbën më shumë se 3% të GDP-së. Prandaj, është thelbësore për Eurozonën t'i orientojë këto kursime drejt investimeve produktive, sidomos duke u mbështetur tek kapitali, gjë që është shumë e rëndësishme për inovacionin ekonomik. Start-upet janë të vetëdijshme për këtë, por duhet të ndërtojë më shumë SME-të evropiane.

Praktikisht, cila duhet të jetë e ardhmja? Një pjesë e mirë e zgjidhjes qëndron në nivel evropian. Përpjekjet e deritanishme janë në drejtimin e duhur, por duhen përshtatur punët për të krijuar atë që unë e quaj “Union Financiar për Investime dhe Inovacion”.

Në këtë kontekst, siguruesit kanë një rol kyç, duke u bërë udhëheqës përmes formave të reja të sigurimit të jetës, që janë të përshtatshme me terrenin me interesa të ulëta, si edhe me nevojat e Eurozonës për investime në aksione.

Ky Union Financiar është përshpejtuesi mikroekonomik, për të cilin kemi nevojë për të shënuar progres të dukshëm drejt një Unioni të mirëfilltë ekonomik në Eurozonë. Shtyllat kryesore për një Union të tillë janë aty:

- Tregu i Kapitaleve të Unionit, që promovon diversifikimin e financimit privat;
- Plani “Juncker” i Investimeve, që kanalizon një përzierje të investimeve publike dhe private drejt ekonomisë reale;
- Unioni Bankar, që adreson fragmentarizimin financiar.

Këtyre iniciativave gjithsesi u mungon drejtimi i unifikuar i një Unioni Financiar, i cili do të ndihmonte në tejkalimin e barrierave burokratike. Por, që ky Union Financiar të funksionojë, nevojitet progres në katër fusha:

- Dhënia e iniciativave për investime ndërkufitare, më së shumti në kapitale, nëpërmjet sistemit të kontabilizimit, taksave dhe ligjeve për aftësinë paguese;
- Zhvillimi i produkteve pan-evropiane të kursimit dhe mekanizmave të investimit, si fondet e kapitaleve evropiane (kjo është me shumë interes sidomos për industrinë e sigurimeve);
- Përfundimi i Unionit Bankar;
- Monitorimi i aktiviteteve financiare dhe rreziqeve që janë të rëndësishme për Eurozonën, siç është sistemi i CCP (Central Counterparty Clearing House – një organizëm që ndihmon tregtimin e Derivativeve Evropiane dhe tregut të kapitaleve).

Në këtë kontekst, siguruesit kanë një rol kyç, duke u bërë udhëheqës përmes formave të reja të sigurimit të jetës, që janë të përshtatshme me terrenin me interesa të ulëta, si edhe me nevojat e Eurozonës për investime në aksione. Kjo do të thotë se siguruesit duhet të zhvillojnë produkte të reja kursimi pan-evropiane. Këto produkte duhet të ofrojnë në kohë kthime më të larta të kapitalit, duke qenë më pak likuide, duke patur ndërkohë edhe një formë mbrojtjeje kapitalesh. Megjithatë është shumë e rëndësishme që inovacionet e produkteve, të vazhdojnë të zhvillohen pa nënvlerësuar mbrojtjen e policëmbajtësve.

Inovacioni Teknologjik

Revolucioni dixhital po krijon shumë mundësi për aktorët financiarë dhe konsumatorët, duke shtuar aksesin në produktet financiare. Në Francë, ne e kemi vërtetuar me shembuj se e mbështesim inovacionin, duke krijuar Njësinë Inovative të Fintech dhe Forumin e Fintech me Autoritetin e Tregjeve Financiare.

Ne si mbikëqyrës duhet të tregohemi mjaftueshëm fleksibël për të stimuluar inovacionin e siguruesve, duke garantuar njëkohësisht ruajtjen e parimeve kryesore të mbikëqyrjes.

Në rastin e siguruesve, revolucioni dixhital fillon me një rishikim të plotë të marrëdhënieve me klientët. Por shkon përtej kësaj. Në epokën e revolucionit dixhital, sektori i sigurimeve mund të sjellë qëndrueshmëri dhe mbrojtje. Dua të nënvizoj dy çështje që mendoj se janë thelbësore: mbrojtja kibernetike dhe *big data*.

Mbulimi ndaj rreziqeve kibernetike, është një shqetësim serioz që prek kompanitë, - të vogla ose të mëdha, - pasi sulmet kibernetike po bëhen gjithnjë e më të shpeshta: në vitin 2016, sulmet kibernetike vlerësohet t'u kenë kushtuar bizneseve deri në 450 miliardë dollarë në nivel global. Megjithë kërcënimet e vazhdueshme, tregu i sigurimeve kibernetike është pak i zhvilluar. Siguruesit mund dhe duhet të frymëzohen nga eksperiencat e tyre për t'u përballur me rreziqet kibernetike, duke i përdorur për krijimin e ofertave të mirëfillta në këtë drejtim.

Çështje tjetër janë të dhënat personale dhe të dhënat masive (*big data*). Siguruesit disponojnë një databazë të plotë të dhënash personale, por edhe përtej kësaj, të cilat nëse do të humbisnin, hakëroheshin, apo publikoheshin, do të sillnin probleme të mëdha. Kjo është një çështje që duhet adresuar me prioritet nga siguruesit, duke përdorur gjithnjë revolucionin teknologjik.

Për ta mbyllur, dua të nënvizoj se inovacioni ka nevojë për kreativitet, si nga mbikëqyrësit, ashtu edhe nga siguruesit. Në këtë kuadër, për siguruesit, u mbetet atyre të formësojnë të ardhmen e tregut dhe për këtë mbetet shumë për t'u bërë. Ne si mbikëqyrës duhet të tregohemi mjaftueshëm fleksibël për të stimuluar inovacionin e siguruesve, duke garantuar njëkohësisht ruajtjen e parimeve kryesore të mbikëqyrjes.

Hungari

www.xprimm.com

25 kompanitë e sigurimit në Hungari raportuan rritje me 7% të volumit të primeve të shkruara bruto, me vlerë 948.1 miliardë HUF (forinta hungareze, monedha lokale) ose 3 miliardë euro. Sigurimet e Jetës u rritën me 5%, ndërsa ato të Jo-Jetës me 9%. Sigurimi i pronës vazhdon të mbajë pjesën më të madhe në treg, me prime të shkruara bruto në vlerën e 177.4 miliardë forintave (rreth 560 milionë euro), i ndjekur nga linja e sigurimit motorik. Sa i përket dëmeve të paguara, siguruesit shpenzuan 364.5 miliardë forinta (rreth 1.16 miliardë euro) për kontratat e sigurimit të Jetës dhe 224.2 miliardë forinta (710 milionë euro) për ato të Jo-Jetës. Gjithashtu u shënuar një rritje e numrit të kontratave me 3.9%.

Qipro

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Qipro e mbylli vitin 2017 me 816.6 milionë euro nga primet e shkruara bruto, me një rritje 6.5%, sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata e Siguruesve të Qipros. Segmenti i Jo-Jetës solli 465.3 milionë euro, me një rritje prej 5.3%. Sigurimi motorik dhe ai i shëndetit mbeten dominues, me një rritje prej 12.3%. Sigurimi i Jetës ka ndjekur një rritje pozitive me rreth 348.4 milionë euro nga primet e shkruara bruto, ose 7.8% më shumë se në vitin 2016. Dëmet e paguara nga siguruesit në vitin 2017 kapën vlerën e 486.3 milionë eurove, me një rritje prej 2.9%.

Serbi

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Serbi e mbylli vitin 2017 me një volum primesh të shkruara bruto në masën 785.8 milionë euro, me 8.8% rritje vjetore, një rezultat i mbështetur pjesërisht edhe nga forcimi i dinarit vendas ndaj monedhës evropiane. Pjesa më e madhe e rritjes erdhi si pasojë e sigurimeve të Jo-Jetës, aty ku primet e shkruara bruto u rritën me 11%. Sa i përket sigurimit të Jetës, rritja ishte vetëm 2.5%. Rritjen më të madhe në të gjithë tregun e shënuar sigurimet motorike, me 17.4%, kjo për shkak të numrit më të madh të makinave të shitura gjatë vitit të kaluar. Sigurimi MTPL shënoi gjithashtu rritje me 10%, duke mbetur dominues në treg, me 34% të portofolit.

Sloveni

www.xprimm.com

Siguruesit slovenë e mbyllën vitin 2017 me volumin e primeve në masën 2.18 miliardë euro, me një rritje prej 5.5% nga viti i kaluar, duke përfituar më së shumti nga rigjallërimi i tregut të sigurimeve të Jetës. Kështu, pas vitit 2016, sigurimet e Jetës shënuan një rritje me thuajse 10% vitin e kaluar, duke i dhënë një stimul pozitiv të gjithë sektorit. Sa i përket sigurimeve të Jo-Jetës, të ardhurat nga primet e shkruara bruto ishin 1.45 miliardë euro, me një rritje prej 4.5%. Kontribuesi kryesor në këtë linjë sigurimesh ishin sigurimet e shëndetit. Gjithashtu, edhe sigurimet motorike kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në rritjen e këtij segmenti të tregut.

Turqi

www.xprimm.com

Volumi i përgjithshëm i primeve të shkruara bruto në Turqi arriti vlerën e 46.5 miliardë TRY (lira turke, monedha vendase) ose 10.3 miliardë euro në vitin 2017, me një rritje prej 15%. Për shkak të zhvlerësimit me rreth 20% të lirës turke ndaj euros, ndryshimi nominal në monedhën evropiane rezultoi negativ (-5.5%). Sigurimi i Jo-Jetës solli 39.7 miliardë TRY (rreth 7.79 miliardë euro), me një rritje prej 12%, ndërkohë që sigurimi i Jetës u rrit me 35.8%. Megjithatë Sigurimi MTPL mbetet dominues në treg, duke sjellë 13 miliardë TRY (rreth 2.55 miliardë euro) prime të shkruara bruto. Gjithashtu u shënuar një rritje me 31.7% e fitimit të siguruesve.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al